



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë _____

PËR

MIRATIMIN E HARTËS SË PËRDITËSUAR TË KUFIJVE
ADMINISTRATVO-TERRITORIAL TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES
VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.115/2014, "Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë" dhe nenit 93, pika 1, të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territorialë të njësive të vetëqeverisjes vendore, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Harta e përditësuar, e kufijve administrativo-territorialë të njësive të vetëqeverisjes vendore, publikohet në Gjeoportalin Kombëtar të administruar nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG).
3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

RELACION
PËR PROJEKTVENDIMIN
PËR
MIRATIMIN E HARTËS SË PËRDITËSUAR TË KUFIJVE
ADMINISTRATVO-TERRITORIAL TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES
VENDORE

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN
TË ARRIHEN

Projektvendimi vjen si propozim i Ministrit të Brendshëm në mbështetje të Kushtetutës dhe të ligjit nr.115/2014, “Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 93, pika 1, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Me miratimin e ndarjes Administrativo-territoriale të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe kufijve të tyre, është e nevojshme miratimi i hartës së përgjithshme të saktësuar sipas përcaktimeve që ka bërë ligji dhe publikimit të saj. Pikërisht nëpërmjet këtij projektvendimi synohet miratimi i hartës së përditësuar të kufijve administratvo-territorialë të njësive të vetëqeverisjes vendore. Me anë të këtij vendimi bëhet e mundur pasja e hartës së saktë të kufinjëve administrativo-territorial të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të miratuar me ligjin nr.115/2014, “Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, proces i cili ka filluar në vitin 2014, nëpërmjet projektit STAR.

Projekti STAR nëpërmjet kontratës me bashkimin e kompanive Geo Consulting, Invent dhe Gent ALBA realizoi një proces (përditësimin dhe formalizimin për vënien në përdorim të informacionit gjeografik për kufijtë territoriale të 61 bashkive) i cili është i përshkruar në të gjitha raportet e dorëzuara. Materialet hartografike dhe përshkruese të produktit përfundimtar të këtij procesi gjithashtu janë dorëzuar sipas kontratës që në dhjetor 2015. Por konfirmojmë se procesi i formalizimit të kufijve të 61 bashkive dhe asistenca jonë në këtë proces ka vazhduar edhe mbas përfundimit të kontratës. Në funksion të trajtimit të kërkesave nga një numër bashkish, Ministri i Çështjeve Vendore kërkoi shtyrje të afateve të formalizimit të kufirit territorial me qëllim zgjidhjen e disa konflikteve të mbetura në pretendimet e Bashkive Kufitare.

Në vazhdim të mbështetjes sonë për formalizimin dhe vënien në përdorim të informacionit gjeografik për kufijtë territorialë të 61 bashkive, bashkë me të gjithë informacionin e plotë dixhital të kufijve të 61 bashkive të Shqipërisë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim nuk është parashikuar në Programin Analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave për vitin 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimin e hartës së kufijve të njërive të qeverisjes vendore, kufij të cilët janë miratuar me ligjin nr.115/2014, "Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë", përveçse është një detyrim ligjor, është i domosdoshëm si për vetë Njësitë e Qeverisjes Vendore por gjithashtu për të gjitha institucionet e tjera të cilat kanë detyrime ligjore në lidhje me përdorimin e saj. Procesi i hartëzimit të kufinjëve ka filluar në vitin 2015 nëpërmjet projektit STAR.

Projekti STAR nëpërmjet kontratës me bashkimin e kompanive Geo Consulting, Invent dhe Gent ALBA realizoi një proces (përditësimin dhe formalizimin për vënien në përdorim të informacionit gjeografik për kufijtë territoriale të 61 bashkive) i cili është i përshkruar në të gjitha raportet e dorëzuara. Materialet hartografike dhe përshkruese të produktit përfundimtar të këtij procesi gjithashtu janë dorëzuar sipas kontratës që në dhjetor 2015. Por konfirmojmë se procesi i formalizimit të kufijve të 61 bashkive dhe asistencë jonë në këtë proces ka vazhduar edhe mbas përfundimit të kontratës. Në funksion të trajtimit të kërkesave nga një numër bashkish, Ministri i Çështjeve Vendore kërkoi shtyrje të afateve të formalizimit të kufirit territorial me qëllim zgjidhjen e disa konflikteve të mbetura në pretendimet e Bashkive Kufitare.

Në vazhdim të mbështetjes sonë për formalizimin dhe vënien në përdorim të informacionit gjeografik për kufijtë territoriale të 61 bashkive, bashkë me sqarime të përmbledhura po dërgojmë bashkangjitur kësaj shkresë informacionin e plotë dixhital të kufijve të 61 bashkive të Shqipërisë.

Në raportet e dorëzuara zyrtarisht janë përshkruar të gjitha detajet e procesit dhe produktit të realizuar nga ana jonë, por mendojmë se është ndihmuese në funksion të procesit të formalizimit të kufijve të bëjmë një përmbledhje sqaruese si me poshtë:

1. Gjendja ekzistuese e dokumenteve teknike të kufirit territorial përpara fillimit të projektit STAR

- Në Shqipëri ndarja administrative deri në ditët e sotme nuk është dokumentuar asnjëherë në funksion të pozicionit koordinativ të kufirit. Hartat e deritanishme të ndarjes administrative kanë pasqyruar në mënyrë tematike ndarjen e pushteteve vendore, por nuk përmbajnë në asnjë rast pozicionin koordinativ (hartografik) të kufijve të tyre.
- Zyrat e kadastrave të rretheve që kanë ekzistuar deri në vitet e para pas 1990, kanë pasur informacion hartografik të kufizuar në territorin e tokave bujqësore dhe njëkohësisht në harta të shkalleve 1:5000 që nuk ishin të një saktësie të mjaftueshme.
- Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (Hipoteka), pavarësisht nga përpjekjet që ka bërë për unifikimin e kufijve administrative të fshatrave dhe komunave me kufijtë e zonave kadastrale, nuk ka arritur që ta realizojë këtë qellim.
- Ndërmarrjet pyjore pavarësisht se kanë pasur informacion për fshatin në të cilin ndodhen parcelat pyjore ato nuk i kanë organizuar hartat e tyre mbi ndarjen administrative por mbi ekonominë pyjore. Si rrjedhim nuk pritët të merret një informacion i sigurtë dhe i saktë duke përdorur hartat e vjetra 1:25000 të ekonomive pyjore.
- Sistemi i Adresave i krijuar në vitet e fundit nuk pati në qellim të vet realizimin e hartës së kufijve territoriale.
- Instituti i Statistikës nuk ka pasur, nuk ka krijuar dhe nuk e krijoj edhe në census-in e fundit (2011) hartën e saktë të kufijve territoriale të Shqipërisë.
- Në disa zona të Shqipërisë janë bërë përpjekje të veçuara për përcaktimin dhe dokumentimin e kufijve administrative por ato janë të veçuara dhe jo në standarde teknike që korrespondojnë me kërkesat e ditëve të sotme.
- Është për t'u vërejtur se kufijtë territorialë sot nuk janë të monumentuar në terren me shenja të veçanta. Në shumë vende ato vetëm dihet se ku janë por në shume vende të tjera njësitë vendore ose nuk kanë njohuri të saktë mbi pozicionin e kufijve në terren ose kanë mendime të ndryshme.
- Si konkluzion mund të thuhet se të gjitha materialet hartografike dhe përshkrimore që ekzistojnë në arkivat Shqiptare, mund të jenë ndihmuese por jo të mjaftueshme për të realizuar dokumentet e nevojshëm teknike që përcaktojnë pozicionin e kufijve territoriale të 61 Bashkive.

2. Gjendja ekzistuese në funksion të autoritetit dhe përgjegjësisë

- Mungon aspekti ligjor mbështetës që përcakton organin apo strukturën administrative teknike dhe ligjore në funksion të administrimit dhe mirëmbajtjes së informacionit të kufijve administrativë.
- Mungojnë manuale apo udhëzuese teknike me rregulla të përcaktuara qartë për trajtimin e kufirit administrativ.
- Ekzistojnë vetëm standarde teknike të informacionit dixhital të Kufijve të krijuara me VKM nga ASIG.

3. Procesi në vija të përgjithshme

Procesi i realizuar nga projekti STAR në vija të përgjithshme kaloi në hapat e mëposhtme:

- U krijua vija e kufirit konsultativ bazuar tek saktësia e ortofoto 2007 dhe përpunimi i hartave të mëposhtme:
 - a) Hartat dixhitale të pasurive të paluajtshme për rreth 2700 zona kadastrale;
 - b) Hartat e të gjithë ekonomive pyjore në të gjithë territorin ku kalon kufiri i 61 bashkive;
 - c) Hartat ekzistuese të planeve të përgjithshme vendore.
- Zyrtarisht secila nga 61 Bashkitë është paraqitur me personin përgjegjës për komunikim, bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni.
- U krijua aplikacion EEB-GIS me të drejtë aksesit të përcaktuar për përfaqësuesit e 61 bashkive ku konsultoheshin të gjitha hartat bazë të nevojshme dhe hidheshin të gjitha pretendimet e bashkive në lidhje me kufirin territorial. Është bërë trajnimi i përqendruar dhe asistim në terren në të gjitha rastet e nevojave dhe kërkesave.
- U përgatiten, printuan dhe u shpërndanë për secilën nga 61 Bashkitë, dy tip hartash:
 - a) Hartë në format A0 që kishte në përmbajtjen e saj hartë bazë topografike dhe kufirin konsultativ në shkallën nga 1:30000 deri në 1:60000 sipas madhësisë së bashkisë.
 - b) Album hartash në formatin A3 në shkallë të madhe që paraqet mbi ortofoto pozicionin e kufirit, përgjatë gjithë vijës së kufirit të secilës bashki.
- Personat përfaqësues të bashkive kanë konsultuar dhe kanë hedhur në sistem të gjitha pretendimet e tyre në lidhje me kufirin konsultativ. Ato janë asistuar dhe trajnuar në vazhdimësi në të gjitha rastet, në zyrë dhe në terren.

Pretendimet e tyre janë trajtuar e vlerësuar dhe sipas rastit janë bërë ndryshime në vijën e kufirit.

- Është mirëmbajtur dhe ndryshuar pozicioni i kufirit territorial deri në momentin e përfundimit të procesit dhe dorëzimit të produktit përfundimtar.
- Kriteret kryesore të trajtimit të pretendimeve kanë qenë:
 - a) Në rastet kur pretendimet për ndryshime kanë qenë në marrëveshje të plotë të kufitarëve është ndryshuar vija e kufirit sipas pretendimit të të dy kufitarëve;
 - b) Pretendimet që kanë qenë në kundërshtim me ligjin e ndarjes administrative nuk janë pranuar (kur pretendimi ishte për një fshat të tërë);
 - c) Pretendimet të pa argumentuara të njëanshme nuk janë mare parasysh. I kemi qëndruar argumentit që tokat bujqësore të fshatit të jenë brenda bashkisë ku fshati është përcaktuar me ligj. Në zonat malore ka prevaluar kufiri i ekonomisë pyjore.

4. Produkti i projektit STAR

- Krijoi një proces gjithëpërfshirës të 61 bashkive në funksion të konsultimit dhe ndërveprimit dhe në shumicë bashkitë u treguan të interesuara dhe bashkëpunuan në proces.
- Krijoi një set me rregulla dhe kriteret për trajtimin e kufirit administrativ të cilat mund të përdoren në procesin e formalizimit apo përpilimin e udhëzuesve dhe rregulloreve teknike.
- Krijoi një produkt i cili në një masë prej mbi 95% të gjatësisë së tij nuk ka kundërshtime ndërmjet palëve kufitare.

Sugjerime mbi formalizimin e Kufirit Territorial të 61 Bashkive

- a) Një zgjidhje e shpejtë në funksion të formalizimit të kufirit të 61 bashkive mirë do të jetë të parashikojë:
 - Vendosjen në fuqi të vijës së kufirit të dalë nga projekti STAR duke referuar si material teknik vijën dixhitale të kufirit të shfaqur në Gjeoportalin e ASIG.
 - Përcaktimin e një agjencie apo institucioni që është përgjegjës për mirëmbajtjen e kufijve të brendshëm administrativ i cili do të duhet të krijojë udhëzues dhe manuale teknike për trajtimin e vijës së kufijve (jo vetëm të bashkive por edhe për fshatrat që kanë një këshill fshati).
 - Mundësi ndryshimi të vijës së kufirit të bashkive në të gjitha rastet kur ka marrëveshje të përbashkët nga bashkitë kufitare dhe që nuk cenojnë ligjin e

ndarjes administrative. Çdo ndryshim hyn në fuqi vetëm mbasi është reflektuar në Geoportalin e ASIG.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi i propozuar është në përputhje me rendin juridik të brendshëm dhe legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS* TË BE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky akt nuk synon përafrimin e legjislacionit me *ACQUIS* së BE.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË DOKUMENTIT

Projektvendimi ka në përmbajtjen e tij si më poshtë vijon:

Në pikën 1 përcaktohet, miratimi i hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territorialë të njësive të vetëqeverisjes vendore, e cila është bashkëlidhur vendimit.

Në pikën 2 përcaktohet se, harta e përditësuar e kufijve administrativo-territorialë të njësive të vetëqeverisjes vendore, të publikohet në Gjeoportalin Kombëtar të administruar nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG).

Pika 3 përcakton organet që ngarkohen për zbatimin e vendimit të cilat janë Ministria e Brendshme, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi janë ministria e Brendshme, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor dhe njësitë e qeverisjes vendore.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË
KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është përgatitur nga Ministria e Brendshme.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE
SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim nuk krijon efekte financiare shtesë në buxhet e shtetit.

MINISTRI

FATMIR XHAFAJ